L I G J
Nr.8162, datë 7.11.1996

PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1630, DATË 1.11.1996 "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7918, DATË 13.4.1995 "PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995 "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË PRIVATIZIMI)" DHE DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995 "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT""

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1630, datë 1.11.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi) dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit" si vijon:

Neni 1 i dekretit ndryshohet si vijon:

"Në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit" bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i nenit 3 ndryshohet: "Bonot e privatizimit do të jenë të vlefshme deri në datën 31.12.1999."

2. Fjalia e fundit e nenit 5 ndryshohet si vijon: "Bonot e privatizimit janë të tregtueshme midis personave fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1645, datë 19.11.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha